

RELACION ARKITEKTONIK

***NDERTIM I PALESTRES MULTIFUNKSIONALE,
REHABILITIMI I TERRENEVE SPORTIVE E TE JASHTME
DHE INSTALIMI I SISTEMIT FOTOVOLTAIK NE
SHKOLLEN E MESME TE BASHKUAR
BULARAT+KOPSHTI BULARAT,DROPULLI I SIPERM***



1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

- Vendndodhja e projektit- Bularat, Bashkia Dropull.
- Objekti i këtij projekti është ndërtimi i një palestre multifunksionale dhe i infrastrukturës sportive mbështetëse pranë Shkollës së Mesme të Bashkuar Bularat+Kopshti Bularat, Dropulli i Sipërm, Bashkia Dropull. Projekti synon krijimin e një kompleksi sportiv dhe komunitar bashkëkohor, i cili do të plotësojë nevojat e procesit arsimor, aktiviteteve sportive dhe jetës sociale të komunitetit.

2. PERSHKRIM I GJENDJES EKZISTUESE

Kompleksi Arsimor i Shkolles se Mesme te Bashkuar Bularat, së bashku me Kopshtin Bularat, përbën një nga institucionet më të rëndësishme arsimore të Bashkisë Dropull dhe i shërben komunitetit të Dropullit të Sipërm. Përveç funksionit të saj si institucion arsimor, objekti shërben edhe si qendër komunitare, ku zhvillohen aktivitete edukative, sociale, sportive dhe kulturore që përfshijnë nxënësit, prindërit dhe banorët e zonës.

Duke qenë se shkolla është pjesë e rrjetit të institucioneve ku zhvillohet arsimi për pakicën kombëtare greke, gjatë vitit shkollor organizohen një numër i konsiderueshëm aktiviteteve edukative, artistike, sportive dhe kulturore. Krahas veprimtarive të parashikuara në kalendarin arsimor kombëtar, zhvillohen edhe aktivitete që lidhen me ruajtjen dhe promovimin e gjuhës, kulturës dhe traditave të komunitetit të minoritetit grek. Për këtë arsye, shkolla ka një rol shumë më të gjerë se ai i një institucioni të zakonshëm arsimor, duke u shndërruar në një qendër aktive të jetës kulturore dhe komunitare të Bashkisë Dropull.

Megjithatë, pavarësisht rëndësisë së saj, kompleksi shkollor nuk disponon infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të këtyre aktiviteteve. Mungesa e një palestre multifunksionale bën që orët e edukimit fizik, aktivitetet sportive, shfaqjet artistike, ceremonitë shkollore, aktivitetet kulturore dhe takimet komunitare të zhvillohen në kushte të papërshtatshme ose të kufizuara, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e procesit arsimor dhe të jetës komunitare.

Gjithashtu, shkolla nuk disponon një fushë sportive të standardizuar për futboll ose kalçeto, çka kufizon mundësitë për zhvillimin e aktiviteteve sportive gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij. Mungesa e ambienteve ndihmëse, si dhomat e zhveshjes, nyjet sanitare dhe hapësirat për pajisjet sportive, e bën të pamundur funksionimin e një infrastrukture sportive sipas standardeve bashkëkohore.

Kompleksi shkollor nuk ka një mur rrethues funksional që të garantojë sigurinë e nxënësve dhe kontrollin e aksesit në territorin e shkollës. Po ashtu, hapësirat e jashtme nuk janë të sistemuara në nivelin e kërkuar, mungojnë sheshet funksionale për grumbullimin e nxënësve dhe zhvillimin e aktiviteteve në ambient të hapur, ndërsa gjelbërimi dhe mobilimi urban janë të pamjaftueshëm për një institucion me këtë rëndësi.

Nga ana tjetër, objekti nuk përfiton nga përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë. Mungesa e një sistemi fotovoltaiik dhe e ndriçimit të jashtëm autonom me ndriçues inteligjentë fotovoltaiikë



sjell kosto më të larta operative dhe nuk përmbush standardet bashkëkohore të eficiencës energjetike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në këto kushte, realizimi i projektit **"Ndërtimi i Palestres Multifunkzionale, Rehabilitimi i Terreneve Sportive e të Jashtme dhe Instalimi i Sistemit Fotovoltaik në Shkollën e Mesme të Bashkuar Bularat + Kopshti Bularat, Dropulli i Sipërm"** paraqitet si një domosdoshmëri për përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe komunitare të zonës.

Ndërtimi i palestrës multifunkzionale, fushës së kalçetos, ambienteve ndihmëse, murit rrethues, sistemimi i plotë i hapësirave të jashtme me pllaka guri, krijimi i sipërfaqeve të gjelbra, si dhe instalimi i sistemit fotovoltaik dhe i ndriçimit inteligjent me energji diellore do të krijojnë një kompleks arsimor modern, funksional dhe energjetikisht eficient.

Për shkak të rolit që kjo shkollë ka në jetën arsimore dhe komunitare të Bashkisë Dropull, si dhe numrit të madh të aktiviteteve edukative, sportive, artistike e kulturore që zhvillohen gjatë vitit, investimi do të ketë një shkallë të lartë përdorimi. Palestra multifunkzionale nuk do të shërbejë vetëm për zhvillimin e orëve të edukimit fizik, por do të përdoret gjatë gjithë vitit për organizimin e veprimtarive shkollore, festivaleve, aktiviteteve kulturore, ceremonive, takimeve komunitare dhe aktiviteteve sportive, duke u kthyer në një qendër funksionale në shërbim të nxënësve dhe komunitetit të Dropullit të Sipërm.

3. KONCEPTI ARKITEKTONIK

Koncepti arkitektonik është bazuar në krijimin e një objekti modern, funksional dhe energjetikisht eficient, i cili respekton karakteristikat tradicionale të arkitekturës së zonës së Finiqit dhe Gjirokastrës.

Volumetria e palestrës është e thjeshtë dhe funksionale, duke krijuar hapësira të bollshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive, ndërsa trajtimi i fasadave kombinon materiale bashkëkohore me elemente tradicionale, si veshja me pllaka guri natyror në pjesën e poshtme të objektit. Ky trajtim krijon një identitet arkitektonik të veçantë dhe siguron integrimin harmonik të godinës me mjedisin përreth.

Në projekt është kushtuar rëndësi orientimit të objektit, ndriçimit natyral, ventilimit dhe lidhjes funksionale me godinën ekzistuese të shkollës dhe terrenet sportive.

4. ORGANIZIMI FUNKSIONAL

Palestra është projektuar si një objekt multifunksional, i aftë të presë aktivitete sportive, edukative, kulturore dhe komunitare.

Organizimi funksional përfshin:

- sallën kryesore multifunkzionale sportive;
- fushën sportive sipas standardeve për basketboll, volejboll dhe aktivitete të tjera;
- ambiente ndihmëse me dhoma zhveshjeje për sportistët;
- tualete për përdoruesit dhe personat me aftësi të kufizuara;
- ambiente teknike dhe depo për pajisjet sportive;



- korridore funksionale dhe hyrje të veçanta për përdoruesit dhe shërbimet.

Pranë palestrës parashikohet ndërtimi i një fushe kalçetoje me përmasa standarde, e pajisur me rrethim metalik, ndriçim dhe elementet përkatëse sportive.

5. TRAJTIMI I FASADAVE DHE MATERIALET

Fasadat janë projektuar duke kombinuar elemente moderne me materiale tradicionale.

Parashikohet:

- sistem izolimi termik (kapot);
- suvatime dekorative për përdorim të jashtëm;
- veshje me pllaka guri natyror në pjesën bazament të fasadës;
- dritare termike me dopio xham dhe profile me ndërprerje termike;
- dyer alumini dhe metalike sipas funksionit të ambienteve.

Ky kombinim garanton jetëgjatësi, performancë energjetike dhe integrim estetik me arkitekturën karakteristike të zonës.

6. SISTEMIMET E JASHTME

Projekti parashikon sistemimin e plotë të hapësirave të jashtme të kompleksit.

Do të realizohen:

- shtrimi i sheshit dhe rrugëve të këmbësorëve me pllaka guri natyror;
- ndërtimi i trotuareve dhe hapësirave të qarkullimit;
- ndërtimi i murit rrethues me trajtim arkitektonik me gur natyror, në harmoni me karakterin tradicional të zonës;
- vendosja e stolave dhe elementeve të mobilimit urban;
- mbjellja e pemëve dekorative dhe krijimi i sipërfaqeve të gjelbra.

Sistemimi i jashtëm është konceptuar për të krijuar një kampus funksional, estetik dhe të aksesueshëm.

7. EFICIENCA ENERGJETIKE

Në projekt janë integruar masa për rritjen e eficiencës energjetike dhe reduktimin e kostove të funksionimit.

Parashikohet instalimi i një sistemi fotovoltaiik për prodhimin e energjisë elektrike, i cili do të mbulojë një pjesë të nevojave energjetike të palestrës dhe ambienteve ndihmëse.

Objekti do të pajiset me sistem izolimi termik, dritare me performancë të lartë energjetike dhe sistem VRF për ngrohje dhe ftohje, duke garantuar kushte optimale komforti gjatë gjithë vitit.

Në ambientet e jashtme do të instalohen shtylla ndriçimi me ndriçues inteligjentë fotovoltaiikë, të cilët funksionojnë në mënyrë autonome, aktivizohen automatikisht gjatë natës dhe kontribuojnë në uljen e konsumit të energjisë elektrike.



8. AKSESUESHMËRIA

Objekti është projektuar sipas parimeve të projektimit gjithëpërfshirës, duke garantuar akses për personat me aftësi të kufizuara.

Janë parashikuar rampa me pjerrësi sipas standardeve, hyrje pa barriera arkitektonike, korridore me gjerësi të përshtatshme, si dhe tualete të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

9. PËRFUNDIME

Ndërtimi i palestrës multifunkionale dhe infrastrukturës sportive shoqëruese do të krijojë një kompleks modern, funksional dhe energjetikisht eficient, i cili do t'i shërbejë procesit arsimor dhe komunitetit të zonës. Investimi përmirëson ndjeshëm cilësinë e infrastrukturës sportive dhe arsimore, rrit standardin e shërbimeve publike, forcon rolin e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Lefter Talo" si qendër komunitare dhe kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të njësive administrative të Livadhjasë.

Pergatiti: "ZENIT & CO" SH.P.K

Ing. REXHEP TARBA



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text "ZENIT & CO Sh.p.k" in the center, with "PROJEKTIM - SUPERVEJEN" at the top and "NPT: K 61731002 D" at the bottom.

IMAZHE 3D





